



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e –I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
17 janar 2019 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 10:45.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Lutfi Bilalli (i cili ka dhënë dorëheqje), Shpëtim Zhegrova, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Adnan Lahu, Sylejman Mehulli, Berat Asllani, Berat Sadiku, Fatmire Cecelia dhe Mehmet Selaci), si dhe nga sekretaria, Haki Maloku, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 dhjetor 2018;
2. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Kryetarit-qeverisë komunale për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;
4. Shqyrtimi i Raportit janar-dhjetor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
7. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 dhjetor 2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me ndryshime aprovoi procesverbalin e datës 15.11.2018.

2. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Kryetarit-qeverisë komunale për vitin 2019.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se në faqen 15, pika 1.5 <ndërtimi i sallave sportive (100.000 €)> dhe pika 1.10 <fusha sportive (60.000€). Si do të përcaktohet ndërtimi i sallave dhe fushave sportive? Me çfarë kriteri?

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se ky draft-plan bazohet në buxhetin që është miratuar në kuvendin e komunës. Sigurisht që edhe kjo çështje është e bazuar në projektet, të cilat ose janë të dakorduara në bazë të strategjisë për arsim ose në kuvend. Por, lidhur me këtë, përgjigje të detajuar do të jep drejtori i arsimit.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – deklaroi se në faqen 51 <pasurimi i bibliotekës së qytetit>, fushata <ne dhurojmë libra> është vazhdimësi, pasi ka qenë edhe në të kaluarën. Kjo më tepër është fushatë vetëdijësuese, sesa që ndikon te pasurimi i bibliotekës së qytetit. A është paraparë nga drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport ndonjë mënyrë tjetër për ta pasuruar bibliotekën dhe a është paraparë buxhet? I kisha sugjeruar drejtoreshës, që në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim, si dhe me mësimdhënësit (e sidomos me mësimdhënësit e gjuhës shqipe dhe mësuesit e klasës) që të bëjnë një listë të librave të domosdoshëm, që të jenë në bibliotekën e qytetit.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - deklaroi se propozimi juaj duhet të merret parasysh. Po ashtu, edhe unë kisha dhënë një propozim që të vendosen raftë në shesh, ku qytetarët dërgojnë libra, të cilat nuk i përdorin. Këtë model e kam parë gjatë një vizite që isha në Gjermani, ku nëpër sheshe të qyteteve kishin vendosur raftë të librave.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – pyeti se a pritet të fillojnë punimet për ndërtimin e parkut industrial në Lumadh? A ka ndonjë pengesë teknike apo politike për këtë vonesë? Kjo për shkak se ka pasur të fillojë në vitin 2018. Ai po ashtu pyeti se deri ku ka shkuar procesi për shujtën ditore në arsimin fillor? Ai tha se në faqen 2 është paraparë <ndërtimi i parqeve në hapësira publike, si dhe sugjeroi që kur bëhet ndërtimi i parqeve në hapësirat publike, të vendosen wifi, që do t'iu shërbenin të rinjve për shfrytëzimin e internetit. Ai pyeti se a ka plan qeveria komunale se deri kur mund të bëhet kycja individuale e ekonomive familjare me ujë të pijes, pasi që është një çështje e rëndësishme.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - lidhur me parkun industrial ai theksoi se vonesat kryesisht kanë qenë për fajin e ministrisë dhe ish-ministrit Bajram Hasani, i cili ka hezituuar për ta nënshkruar. Edhe pse, me amendamentin për buxhetin e vitit 2018 ishin paraparë 1.200.000€, për shkak të këtyre vonesave ka gjasa që këtë vit të na shkojnë suficit 400.000€. Ndërkaq, lidhur me shujtat nuk jam i informuar deri ku ka shkuar procedura, për shkak se edhe unë sot jam kthyer nga pushimi.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – lidhur me çështjen e ujit të pijes, së bashku me kryetarin e nënkryetarin kemi zhvilluar një takim me ministrin e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, Valdrin Lluka, në mënyrë që projektet për kycjet individuale të përfshihen në projektet zvicerane që ministria ka bashkëpunim dhe me CDF e që komuna më herët ka pasur bashkëpunim. Për vitin 2018 kjo ka qenë e pamundur, kurse për vitin 2019 më kanë kthyer një përgjigje se me këtë program që e kanë organizatat zvicerane është e pamundur të përfshihen,

sepse sipas marrëveshjes që ka qenë, komuna e ka marrë përsipër t'i bëjë kyçjet individuale, kurse kompania dhe organizata që e ka mbështetur e kanë marrë përsipër shtrirjen e rrjetit, tha Aliu. Do ta ripërsëritim kërkesën tonë edhe njëherë, në mënyrë që ta shtyjme përpara këtë çështje.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - një nga prioritetet për vitin 2019 në shërbime publike, ka qenë shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe e kanalizimit. Prandaj, përveç buxhetit të komunës, kemi kërkuar edhe bashkëpunim nga donatorët lidhur me këtë. Ai tha se sipas ligjit, komuna nuk e ka për obligim që t'i kryejë kyçjet individuale, por kjo nuk do të thotë që është e ndaluar. Prandaj, ne jemi të përkushtuar që t'i bëjmë kyçjet individuale në të gjitha fshatrat dhe lagjet urbane, ku është e mundur dhe ka shtypje të mjaftueshme nga ujësjellësi. Në ato vende ku nuk është i mundur furnizimi nga ana e ujësjellësit, të bëhet funksionalizimi i puseve apo edhe ndërtimi i puseve të reja, të cilat do të mund t'i furnizonin qytetarët me ujë të pijes.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – atë që e përmendi nënkryetari quhen stacione të pompimit, por në kohët moderne tash nuk po ndërtohen këto stacione. Ai tha se po përdoret një metodë tjetër për vendosjen e pompave në gyp. Ai tha se në tërë Kosovën, menaxhimi i ujësjellësve ka kaluar në menaxhim të ministrisë. Prandaj, komuna investon në ujësjellës, duke ndërtuar rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit dhe në njëfarë mënyre ia dorëzon ministrisë. Por, ata nuk duan që ta bëjnë as pranim-dorëzimin për këtë çështje, sepse nuk duan që të marrin përgjegjësi. Lidhur me kyçjet individuale, Klinaku tha se shumë qytetarë mezi kanë pritur që t'iu vjen uji. Prandaj, komuna mund ta bëjë një marrëveshje me ministrinë, që qytetarëve t'iu hiqet pagesa për kyçje, por këtë ta mbulojnë ata. Kurse, gypat nga rrjeti kryesor deri në shtëpitë e tyre qytetarët mund t'i blejnë vetë. Problemi është krejt te pagesa, që është mbi 100 euro për kyçje.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se në fshatin Pestovë jemi afër përfundimit të kyçjeve individuale dhe se afër 200 euro ka shkuar çmimi për një kyçje. Ai tha se komuna po e merr përsipër komplet kyçjen nga gypi sekondar e deri në oborr brenda. Sadiku tha se kemi pasur një takim me drejtorin teknik të ujësjellësit regional, Kadri Istrefi, i cili na tha se si kompani ua sigurojmë 2500 orëmatës. Ai tha se në tender do ta shpallim pa orëmatës, pra kyçja nga gypi sekondar deri në oborrin e qytetarëve dhe ky çmim do të sillet nga 150-200 euro. E kemi kompaninë e kontraktuar për hartim të projektit, kurse inxhinierët tanë janë duke e verifikuar gjendjen në terren, ku kanë mbetur që të testohen fshatrat Sfarçak, Samadrexhë se a ka ndonjë rrjedhje të ujit (ngase në vitin 2009 është vendosur gypi sekondar).

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se nëse qytetarëve u hiqet tarifa për kyçje dhe orëmatësi, konsideroj se nuk do ta kenë problem ata për blerjen e gypave.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – ajo pyeti se a kemi vend të mjaftueshëm për ndërtim të vend-parkingjeve në qytet?

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se si qeveri komunale jemi duke bërë përpjekje për evidentimin e parcelave të komunës dhe të gjejmë vendin e përshtatshëm për ndërtim të parkingjeve publike.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – theksoi se kriteret në arsim janë të lehta për t'u përzgjedhur. Nëse tejkalohe kufijtë buxhetor, atëherë shkohet sipas kriterit ku ka masivitet

më të madh. Ai tha se në disa lokacione ku ne duam të investojmë, ka ende probleme pronësore, ku ende prona nuk është në pronësi të komunës.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se në pikën 28 të këtij draft-plani janë <aktivitetet për eliminimin e deponive ilegale>. Duhet të ceket se për çfarë deponi ilegale bëhet fjalë.

Në pikën 30 flitet për <kontrollimi i kombibusëve për mostejkalimin e numrit të nxënësve>. Ai tha se duhet të keni kujdes në këtë, sepse kombi-busët nuk ekzistojnë. Klinaku theksoi se asnjë nuk ka të drejtë t'i transportojë nxënësit me mjetet motorike që po e bëjnë aktualisht. Prandaj, nuk është mirë të ekzistojë në dokumente zyrtare kjo. Në pikën 32 të këtij drafti <përcjellja e rasteve të shkuarjes së individëve në luftërat e huaja (ISIS) dhe ndërmarrja e masave ligjore>. Konsideroj që kjo ISIS duhet të hiqet, sepse në bazë të kësaj që është shkruar vetëm në ISIS nuk bën të shkohet, kurse në vendet tjera mund të shkohet.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – për kontrollimin e transportit të nxënësve, ajo pyeti se a është fjala për transportin që e organizon komuna?

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – deklaroi se për kontrollimin e transportit të nxënësve fjala është për transportin e kontraktuar nga komuna. Për secilin automjet transportues, ne e kemi të kontraktuar edhe numrin e ulëseve.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se në pikën 8 <pengimi dhe parandalimi i vetëvrasjeve> më së shumti mund të ndikojnë familjet për t'i parandaluar rastet e vetëvrasjeve. Haradinaj përmendi një tentim-vrasje në fshatin Stanoc, i cili siç tha ai për fat të mirë ka shpëtuar. Ai pyeti se ne si komunë çfarë mund të bëjmë që t'i integrojmë këta persona në shoqëri. Sa i përket parandalimit të aksidenteve në rrugë, fshati Stanoc ka qenë i atakuar në këtë çështje, por falë bashkëpunimit me komunën dhe Ministrinë e Infrastrukturës është bërë një punë e mirë, ku janë vendosur mjetet sinjalizuese dhe është vendosur shenja për kufizim të shpejtësisë në 60 km/h , e që ka qenë 80km/h. Ndërkaq, sa i përket dukurisë së vjedhjeve, ai sugjeroi që policia e Kosovës t'i shtojë masat e kontrollit, në mënyrë që të parandalohet kjo dukuri.

Sylejman Mehollu, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – theksoi se është njoftuar nga një punëtor i urgjencës për rastin në fjalë të tentim-vetëvrasjes dhe fatmirësisht ka shpëtuar. Ai tha se duhet të bëhet forcimi i kapaciteteve të shërbimeve sociale dhe atyre psikologjike. Pra, angazhimi i një psikologu klinik në Qendrën për Punë Sociale do të ishte një hap i mirë në këtë drejtim.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – lidhur me pyetjen që e shtroi Ymeri se çka komuna mund të bëjë në këtë drejtim, Klinaku deklaroi se komuna mundet shumë të kontribuojë në këtë drejtim, të jetë transparente, të ketë llogaridhënie, në mënyrë që qytetarët mos të demoralizohen për të konkurruar në vende të punës, dhe mos të diskriminohen. Pra, komuna mos të mbajë zyrtarë në punë me kontratë mbi vepër qe 4 vite, por të shpallë konkurse dhe t'iu jep mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve. Të gjitha këto, janë elemente që qytetarët vijnë deri te stresi.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Raportit janar-dhjetor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se dallimi në mes të të hyrave vetanake nëpër drejtori prej vitit 2017 që ka qenë 92% në bazë të planifikimit, kurse për vitin 2018 është 79% i planifikimit të buxhetit që është diku rreth 292947.76€ më pak. Ai tha se këto drejtori janë më ulët: Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Inspektive, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Kurse, këto drejtori janë më lart: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Po ashtu, <gjjobat dhe të hyrat tjera> janë më lartë në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017. Pastaj tha se te shpenzimet operative, kategoria <mallra dhe shërbime> në vitin 2018 ka shpenzime më shumë (2058438.97€) se në vitin 2017 (1397120.51€). Lidhur me kodet ekonomike 13130 <shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit>, 13131<akomodimi> dhe 13133 <shpenzime tjera>, ai pyeti se çka nënkupton kodi 13133 <shpenzime tjera> brenda Kosovës në vlerë 150 € dhe kodi 13143<shpenzime tjera> jashtë vendit në vlerë 3254.78€? Duke u bazuar në opozitën që gjendet në qeverinë qendrore (LDK dhe VV), ata po i thonë pozitës se për këto shpenzime tjera, a mos vallë iu kanë blerë bizhuteri grave të tyre. Prandaj, po kërkoj sqarime lidhur me këto shpenzime, tha Klinaku. Po ashtu, ai kërkoj sqarime lidhur me kodin 13460 <shërbime kontraktuese tjera>, që sipas Klinakut është një dallim i madh nga viti paraprak. Klinaku kërkoj sqarime edhe për kodet 13501, 13503,13504,13505 dhe 13509 <blerje në vlerë më pak se 1000€>. Ai kërkoj sqarime edhe për kodin 13810< Avans për para të imëta-petty cash>. Sipas Klinakut, totali i shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ka qenë 2058438.97€, krahasuar me vitin 2017 që ishte 1397120.51€. Totali i shpenzimeve komunale në vitin 2018 ka qenë 257640.94€, krahasuar me vitin 2017 që ishte 232614.44€. Totali i subvencioneve në vitin 2018 ka qenë 158115.00€, krahasuar me vitin 2017 që ishte 187426.00€. Ndërkaq, totali i shpenzimeve operative në vitin 2018 ka qenë 2474194.91€, krahasuar me vitin 2017 që ishte 1817161.13€. Pra, diferenca e shpenzimeve operative në mes të vitit 2018 dhe vitit 2017 është 657033.78€. Nëse e mbledhim këtë shumë me të hyrat vetanake që janë më pak 292947.76€ del të jetë 949981.54€, pra afër 1 milion euro më pak.

Klinaku theksoi se nga kjo mund të vijmë në përfundim se kryetari i komunës nuk është transparent dhe s'po del se harxhon 13 euro në javë, i cili shtoi se kjo është fyerje për intelegjencën e qytetarëve të Vushtrisë. Nuk jam kundër shpenzimeve që bëhen, por kërkoj që të jenë transparente, tha Klinaku.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se tabela për mallrat dhe shërbimet është korrigjuar nga Kontabiliteti i Thesarit të Ministrisë së Financave dhe kemi disa ndryshime. Tek kodi 13820 është shuma 649.35€, e jo qysh ka qenë 13026.23€, pasi që ministria i ka futur në dy vende. Edhe tek kodi 13141 është 16133.20€, e jo 18113.20€. Prandaj, për kuvend do ta përgatisim me këto ndryshime, tha ai. Ai theksoi se e kemi thënë disa herë që arsyja pse kemi të hyra më pak në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 është se kemi të hyra më pak nga lejet, ku në vitin 2017 kanë qenë të hyra nga lejet 700000€, kurse në vitin 2018 kanë qenë 200000€. Tek shpenzimet, akomodimi nënkupton fjetjen e zyrtarëve që shkojnë jashtë vendit. Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit janë shpenzimet që i ka bërë ansambli “Hasan Prishtina”, i cili ka marrë pjesë në festivale. Po ashtu, edhe sindikata i ka bërë disa shpenzime brenda vendit për një manifestim për 8 Mars, kurse në shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit

përfshihen biletat e aeroplanit. Shpenzimet tjera jashtë vendit nënkupton, shpenzimet që i bëjnë jashtë vendit kur paguajnë shpenzime për trena e autobusë që nuk janë të hequra. Mjetet më pak se 1000€, shumica prej tyre janë për shkolla, janë mjetet e konkretizimit nga huamarrja. Për shkak se ka dështuar dy herë tenderi për blerjen e kompjuterëve, është dashur që ta bëjmë me procedurë të shpejtë në vlerë nën 1000€. Kurse, avans për para të imëta (petty cash) janë mjetet që i marrin për t'i shpenzuar për udhëtime jashtë vendit. Pra, edhe këtu është një gabim se nuk është 9150€, por është 650€.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se buxheti për vitin 2018 qenka shpenzuar 90% në një masë të kënaqshme. Prandaj, po më vjen mirë për këtë, pasi që ka qenë “brengë” e opozitës se nuk është duke u shfrytëzuar buxheti dhe do të shkojë në suficit. Ai tha se e kam bërë një kërkesë në tetor që neve si anëtarë të kuvendit të na sigurohet nga një llaptop, në mënyrë që të na shërbejë për punë. Ai pyeti se deri ku ka shkuar procedura lidhur me këtë çështje?

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – tha se kur është planifikuar buxheti, është dashur që ta parashohim blerjen e llaptopëve dhe ta fusim si kategori të veçantë. Ai tha se qeveria komunale duhet të has në mirëkuptim për këtë çështje dhe gjatë vitit apo me rishikim të buxhetit ta parashoh blerjen e llaptopëve për anëtarë të kuvendit të komunës.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – nëse do të ketë ridestitim të mjeteve financiare mund të realizohet kjo çështje.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – kërkoi që shpenzimet për udhëtime jashtë vendit të ndahen në bazë të drejtorive dhe po ashtu edhe zyra e kryetarit të jetë e veçantë.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se këtë mund t’ua japim në mënyrë individuale kush e kërkon, por si material kjo është tabela që s’mund ta ndryshojmë, sepse këtë e dorëzojmë në ministri.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tek investimet kapitali-granti qeveritar, ai tha se tek asfaltimi i rrugëve në Zhilivodë sa jam në dijeni kanë qenë 12000€ nga granti qeveritar. Këtu po shkruan që kanë mbetur 22000€, kurse rrugët në Zhilivodë nuk janë asfaltuar. Ku është problemi?

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se ka filluar pjesa e bazamentit për rrugët në fshatin Zhilivodë, që do të thotë se mjetet nga granti janë shpenzuar.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se çka do të ndodh me projektet që nuk kanë filluar fare dhe në vitin 2019 nuk figurojnë, a rrezikon të humb krejt ai projekt?

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se ai projekt rrezikohet të humb krejt.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – sqaroi se këtu kemi të bëjmë me disa prona për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, në mesin e tyre është prona tek “Ura e Gurit”, ish-prona e gjykatës, stadiumi i vogël i qytetit dhe e kemi një ndërtesë kolektive që është në pronësi të komunës, ku kemi kërkesë prej banorëve të asaj ndërtesë që të jepet për rindërtim.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së – tha se mirë do të ishte të sqarohet edhe në dokument se ku gjenden pronat. Pra, aty ku shkruan parcela, në kllapa mund të sqarohet se për cilën pronë është fjala.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se pse është propozim për 40 vite, e mos të jepen në shfrytëzim pronat për 99 vjet, pasi që investitorët mund të shprehin interes më shumë.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kasastër dhe Pronë – tha se kemi menduar se aty ku ka investim më të madh, të jepet për 99 vjet, siç është rasti tek prona ku gjendet ndërtesa kolektive. Kurse, për këto tjerat, ne e kemi dhënë si propozim për 40 vite, kështu që është kuvendi ai që vendos se për sa vite.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti se a është e paraparë veprimtaria për ata që investojnë tek dhënia në shfrytëzim afatgjatë? Si dhe dhënia në shfrytëzim të bëhet në bazë të kriterëve. Pra, mos të jepet në shfrytëzim për një veprimtari tjetër , e më pas shfrytëzuesi ta ndryshojë veprimtarinë, tha ajo.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kasastër dhe Pronë – deklaroi se për të gjitha këto prona kemi bërë përpjekje që ta japim një arsyeshmëri, pasi që mirëmbajtja i kushton komunës shumë. Tek objekti i ish-gjykatës, kanë filluar që t’i thyejnë xhamat dhe dyert. Prandaj, kemi menduar se si komunë mund të përfitojmë nga dhënie në shfrytëzim. Ai tha se komisioni i parasheh kriteret, që duhet të merren parasysh.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se ish-objekti i gjykatës ka arkitekturë të mirë dhe ideja më e mira është që të jepet në shfrytëzim. Edhe nëse ndërtohet hotel nuk ka asgjë të keqe, sepse kemi delegacione nga shtetet e huaja dhe mund të vendosen aty.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota “për” dhe një (1) “abstenim” e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kasastër dhe Pronë – sqaroi se shumica e pronave që janë propozuar që të jepen në shfrytëzim janë për bujqësi, kurse dy parcela që gjenden afër magjistrale janë për afarizëm.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së - pyeti se për cilat prona është fjala në zonën kadastrale Stanoc?

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kasastër dhe Pronë – sqaroi se për zonën kadastrale Stanoc, fjala është për disa prona tek hekurudha poshtë, gati në Prelluzhë.

7. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **12:50**.

Bujar Klinaku

Belić
Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së